



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9163 Prot.

Roskovec, më 31, 10 2025

VENDIM

NR. 58 . DATË 30 . 10 . 2025

***“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN SHTATOR 2025”***


Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 30.09.2025, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Shtator 2025.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8353/Prot.

Roskovec, më 01.10.2025

Procesverbal Nr.9

-I mbajtur sot, datë 30.09.2025, ora 13⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Gusht 2025.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Gusht 2025.
5. Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA).
6. Për dhënien me qira të ambienteve përkatëse për tu përdorur si zyra administrative nga Shoqëria Rajonal Ujësjiellës Kanalizime Fier ShA.
7. Për kalimin e pasurisë shtetërore në pronësi nga Bashkia Roskovec te Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në funksion të Postës së Policisë Roskovec.
8. Për miratimin e dokumentit të rishikuar të PBA 2026-2028.
9. Për miratim fondesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2025.
10. Për miratimin e rregullores për menaxhimin e hapësirës publike në Bashkinë Roskovec.
11. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13⁰⁷

Këshilltarët prezent: A.Plaka, E.Çepele, Rr.Hazizi, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, Zh.Metushi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, E.Toska, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, P.Toro, S.Bibo Qamili, F.Feleqi.

Këshilltarët që mungojnë: A.Lamaj, J.Begaj, A.Hoxha, A.Pelo, V.Çepele.

Prezent nga bashkia: Nënkryetari M.Goga, Dr.Ekonomik S.Çepele, Dr.Juridik V.Zeqo, Dr.Urbanistik E.Hoxha, P/Shërbimit Social S.Saliaj.

Me plotësimin e kuorumit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 15 këshilltar. Kryetari –përshëndetje këshilltar, faleminderit që jeni bërë pjesë e kësaj mbledhje të Këshillit të Bashkisë Roskovec, pikërisht të mbledhjes së muajit Shtator. Ashtu siç jeni njohur, në datën 25 të këtij muaji u mbledh Kryesia e Këshillit të Bashkisë Roskovec për të shqyrtuar gjithë projekt-vendimet e ardhura nga administrata e Bashkisë, në bazë të të cilave është formuluar rendi i ditës për këtë mbledhje të radhës të Këshillit të Bashkisë Roskovec, besoj që jeni njohur në kohën e përcaktuar nga rregullorja me të gjitha këto materjale. Ka dikush ndonjë vërejtje sa i takon rendit të ditës, për diskutim ? Nuk ka. Kryetari-ju ftoj atëherë të nderuar këshilltar të votoni rendin e ditës së kësaj mbledhje. Në këtë moment vjen këshilltarja Sara B.Qamili. Prezent tani në sallë 16 këshilltarë.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari hedh në votim rendin e ditës dhe miratohet unanimitisht me 16 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Gusht 2025.

Kryetari-vazhdojmë me një informacion të shkurtër në lidhje me vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Gusht 2025. Sekretarja e Këshillit- në mbledhjen e fundit të muajit Gusht ju keni miratuar 7 vendime, të cilat i keni të listuara sipas numrit dhe titujve në informacion dhe nga këto 7 vendime 3 prej tyre ishin vendime normative, të cilat i nisëm në Prefekturë për verifikim ligjor dhe të 3 vendimet janë miratuar nga Prefektura. Pastaj e dini procedurën, pas hyrjes në fuqi shpërndahen në zyrat e Bashkisë për zbatime të mëtejshme.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari- të nderuar këshilltar jeni njohur gjithashtu me procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, procesverbal të mbajtur më datë 28.08.2025. Kryetari hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimitisht me 16 vota pro.

4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Gusht 2025.

Kryetari-presim pak minuta sa specialistja të paraqitet për ta relatuar, gjithsesi sipas një marrëveshje që kemi bërë në lidhje me këtë projekt-vendim, ju lutem në qoftë se nuk ka interes të dëgjojmë relacionin, mund të më thoni. Po, fjala është për znj.Dhurata. Dhurata-mendoj që ska nevojë por thjesht një pyetje kisha në lidhje me çfarë u bë me atë znj.Rredhi nga fshati Marinëz? Sidorela- e bëri aplikimin këtë muaj, presim përgjigje nga sistemi. Dhurata- për sa vjen përgjigja? Sidorela-besoj sot mbasdite ose nesër, gjithashtu u ndihmua me mjete shkollore, me çanta, me rroba. Dhurata-ok, faleminderit. Kryetari-atëherë thamë që nuk kemi nevojë për të dëgjuar relacionin, për pyetje dikush tjetër e kërkon fjalën? Diskutim ka dikush në lidhje me këtë projekt-vendim? Pyetje dhe diskutime nuk kemi, ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Gusht

2025". Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 16 vota pro.

5. Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore,akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA).

Kryetari-ky projekt-vendim vjen për herë të dytë në mbledhjen e Këshillit, pasi në mbledhjen e parë nuk ka marr votat e mjaftueshme. Ftoj specialisten që të bëj një relacion të përmbledhur, shkurtimisht të përmbledhur që të jetë dhe çik më e qartë. Elmazi-materjalet secili grup i ka përpara. Dhurata- ja ta përmbledhi njëherë. Kryetari-shkurtimisht diçka të përmbledhur. Dr.Juridike Vjollca- njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrim dhe të drejtë trajnimit e stafit të Bashkisë, po ashtu edhe këshilltarët kanë të drejtën e trajnimit. Me qëllim zhvillimin profesional dhe kualifikimin e të gjithë të zgjedhurve, nënpunesve civil dhe punonjësve të tjerë në njësinë e qeverisjes vendore, me qëllim rritjen e performancës profesionale për ti shërbyer komuniteteve dhe për ti ndihmuar ato në përmbushjen e funksioneve të veta dhe kompetencave, si dhe në përmbushjen e sfidave që lidhen me procesin e Integritit në Bashkimin European, në Korrik të këtij viti është miratuar VKM-ja 405 që autorizon Ministrin e Pushtetit Vendor për të lidhur një marrëveshje bashkëpunimi, e cila do të funksionojë në formën e subjektit të kompetencave të përbashkëta dhe qëllimi është trajnimi i stafit të njësive të vetëqeverisjes vendore. Çdo vit njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin që të miratojnë dhe një buxhet për trajnimin e stafeve, pikërisht dhe nga ana e Këshillit të kësaj Bashkie për buxhetin e vitit 2025 është miratuar fondi për këtë qëllim, si rezultat edhe të një shkrese të ardhur nga Agjensia e Vetëqeverisjes Vendore. Bashkisë Roskovec i është vënë në dispozicion marrveshja Tip që do të shërbejë për këtë qëllim, për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta si dhe akti i themelimit. Duke qënë se Ministri i Pushtetit Vendor është i autorizuar me VKM-në 405 të miratuar në Korrik të këtij viti, atëherë lind detyrimi që dhe Kryetari i Bashkisë të autorizohet për firmosjen e marrëveshjes Tip dhe të aktit të themelimit që iu është vënë në dispozicion bashkëngjitur këtij materjali. Ju ftoj të miratoni këtë projekt-vendim. Kryetari-faleminderit, e kërkon ndonjë këshilltar fjalën për pyetje në lidhje me këtë projekt-vendim ? Fredi- ju thatë që keni miratuar një zë në buxhetin e Bashkisë, ne si Këshill për këtë qëllim. Vjollca-po. Fredi-nuk është e vërtetë sepse atëherë nuk kishte dal Vendimi i Këshillit të Ministrave, atë fond e kemi miratuar gjatë gjithë kohës për stafin, për Këshillin Bashkiak, për seminare, për të gjitha dhe nuk është e vërtetë sepse nuk e përmban ai. Në qoftë se do të miratohet kjo, na kërkohet absolutisht ndryshimi i këtij zëri dhe shtesë fondesh, se nuk ka më atë zë që kemi miratuar ne..Vjollca-këtë gjë mund ta konfirmoj dhe Drejtori i Financës. Fredi-jo jo se është llogjike ska nevojë fare as për ashtu, se ne e kemi miratuar vit për vit atë zë dhe atëherë nuk kishte dal Vendimi i Këshillit të Ministrave në Korrik doli, ne e kemi miratuar buxhetin shpejt dhe kështu që nuk është ai zë që thoni ju. Vjollca-për këtë vit është ai zë, vitet në vijim do miratohet për tre vitet e para. Selmani-nuk kishte dal VKM-ja por kishte dal një ligj për këtë gjë, për krijimin.. Fredi-nuk do të duhet ndryshim? Selmani-dhe në bazë të atij ligji na erdhi një shkresë nga Ministri i Pushtetit Vendor, nga Agjensia që na tha që juve sipas numrit të banorëve, madhësisë së Bashkisë dhe numrit të punonjësve, u takon kaq lekë për të dhënë në vit, të gjitha bashkive jo vetëm ne. Fredi- jam dakort por nuk do kemi nevojë për ndryshim? Selmani-jo

se është si zë më vete për këtë. Vjollca-për këtë vit është e përcaktuar, në vitet në vijim do përcaktohet përsëri, për tre vitet e para..Dhurata-tani ne e prekëm pak këtë temën dhe në mbledhjen e muajit të kaluar por unë një pyetje më shumë për diskutim e kisha, nuk e shikoj të arsyeshme fare dhe sështë në dorën time dhe as të kolegëve të mi që duam apo sduam ne, megjithatë përsëri ne e kemi në dorë për ta miratuar ose jo këtë, por e ke parasysh tani qeveria merr parasysh trajnimin e punonjësve të Bashkisë dhe të gjithë stafit e të tjera me radhë, ku mendohet që në staf në Bashki të gjithë punëtorët të jenë me diplomat e duhura se kështu pretendohet, pse duhet të jenë trajnimet duke e ditur që Bashkia ka shumë problematika në lidhje me fermerët, pse nuk ngrihet një komision, një organizatë që të udhëheq këta fermerët, të dali diku por asnjëherë nuk merret çështja e fermerëve, popullit që është në qendër të vëmendjes. Vjollca-ndjesë që të ndërhyjë, ligji për vetqeverisjen vendore e ka të detyrueshme trajnimin e stafit, po kështu dhe këshilltarët duhet të trajnohen sipas kalendarit që miratohet nga Këshilli Bashkiak. Dhurata-dhe nga kjo organizatë jofitimprurëse? Vjollca-po nga kjo, TALGA do jetë për këtë qëllim se është dhe për të zgjedhurit dhe për nënpunësit civil dhe për punonjësit e tjerë që janë administrativ ose të ndërmarrjeve vartëse. Deri më tash trajnimet janë kryer për nënpunësit civil që i ofronte shkolla e Administratës Publike, kurse kjo do jetë pikërisht për këtë qëllim dhe unë mendoj që një administratë, një staf i trajnuar mirë është i aftë profesionalisht për të dhënë shërbime cilësore në komunitet. Dhurata-po mirë dakort se ti ke mendimin tënd sigurisht dhe unë kam timin por duke iu referuar që edhe Kryeministri vet i ftoi të gjithë deputetët të bënin atë trajnimin 2 mujor sepse kjo është 2 vjetore apo jo? dhe them unë tani që janë ca gjëra pa vlerë, pa sens në momentin që ne kemi shumë problematika që mund të zgjidhen në këtë formë, kështu e mendoj unë. Vjollca-këto materjale iu janë shpërndarë të gjithave bashkive duke qënë se është detyrim ligjor. Dhurata-po se vë në dyshim sepse mos ta përsëris prapë se Kryeministri ftoi të gjithë deputetët, bën trajnim 2-3 mujor para se të futeshin në Parlament apo jo, dhe çfarë thotë Kryeministri zbatohet poshtë se jeni të detyruar ta bëni ju, kurse ne të opozitës sikur se shikojmë të arsyeshme duke parë problematika më të qenësishme, më reale që e ka kapur Bashkinë tonë sot, gjithsesi faleminderit. Kryetari-fjalën e kërkon dikush tjetër? Për diskutim në lidhje me këtë projekt-vendim? Nuk ka. Kryetari-atëherë pyetje dhe diskutime në lidhje me projekt-vendimin nuk kemi më nga salla, ju ftoj atëherë të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore,akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur, dhe miratohet me 13 vota pro, 3 vota kundër Dh.Malka, F.Feleqi, E.Xhaxhaj. Miratohet ky projekt-vendim.

6.Për dhënien me qira të ambienteve përkatëse për tu përdorur si zyra administrative nga Shoqëria Rajonal Ujësjellës Kanalizime Fier ShA.

Dr.Juridike Vjollca-të nderuar këshilltar, në muajin Gusht të këtij viti Drejtoria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Sh.A Fier ka paraqitur një kërkesë për marrjen me qera të ambjenteve për tu përdorur si zyra për njësinë e ujësjellës kanalizime të Roskovecit. Bashkia Roskovec është pronare me inventar të pronave publike në Njësinë Administrative Kuman, të pasurisë të cilën ua kemi vënë në dispozicion dhe planvendosjen, dhe përfshin një objekt rreth 170 m² për një sipërfaqe truall 512 m² dhe në kuadër të ushtrimit të të drejtës së pronësisë që ushtrohet në bazë të ligjit për

vetqeverisjen vendore, kjo e drejtë është e drejtë legjitime e Këshillit Bashkiak. Me qëllim miratimin e këtij projekt-vendimi ua paraqesim për shqyrtim dhe miratim nga ana juaj, duke qënë se është e drejta juaj ta miratoni. Kryetari-faleminderit, fjalën e ka kërkuar z.Fredi për pyetje. Fredi-aktualisht ata janë të ndodhur atje? Me qera apo pa qera? Vjollca-po janë të ndodhur atje por duhet të bëjmë një marrëveshje. Fredi-janë jo ligjërisht atje, në kundërshtim me ligjin. Vjollca-njësia e Roskovecit ka qënë më përpara pjesë e shoqërisë..Fredie di e di absolutisht por në momentin që u ndanë si shoqëri, ata janë privat dhe ne i kemi lënë jo ligjërisht aty, ata sot qëndrojnë kundra ligjit, ose në marrëveshjen që është, është parashikuar qeraja kur fillon, që kur kanë filluar të rrijnë ata që janë futur aty? Për çmimin e qerasë, a është bazuar në çmimin e referencës? Vjollca-menjëherë nëse do të miratohet ky projekt-vendim, do ngrihet një grup pune që do përcaktojë vlerën e qerasë që do jepet kjo lloj godine. Nëse është me manual çmimi do përcaktohet atje, në qoftë se do jetë me studim tregu..Fredie është me manual sepse ja keni dhënë një privati këtu çmimi në stratosferë, ky atje për një copë bukë e kupton? Duhet të kishim dhe çmimet. Vjollca-do ngrihet grupi i punës që do e përcaktojë këtë gjë, kjo është miratim në parim për dhënien me qera. Maksi- ShA ujësjellës Roskovec varej nga Bashkia dhe Këshilli i Bashkisë..Fredie di, e di. Maksi-u krijuar ShA ujësjellësi Fier me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe të kalonin të gjitha pronat dhe pasuritë në ShA ujësjellës Fier, deri tani ne kemi qënë aksioner dhe jemi aksioner me 4.9% se kaq na bie dhe në këto kushte nuk kemi pasur një marrëveshje me ta për zyra, që nga dita që ka kaluar shoqëria aksionere Fier dhe është sektor këtu, do të merret qeraja. Dhurata-tani ju thatë që ka qënë dikur dhe tani sa ta mari, do vij ai personi ta marri me qera, kujt do i shërbejë, çfarë pune do bëj ai sepse është viti i tretë që po ngre unë zërin fuqishëm për ujësjellësin këtu, për problematikat që ka patur ujësjellësi tërë kohën, të paktën Njësia Administrative Strum poshtë dhe asnjë përgjigje skemi marr deri tani. A kanë qënë në punë këta deri dje, ky personi që do vij këtu dhe do i ofroni zyra, do i shërbejë këtij komuniteti? Maksi-nuk është person, nuk i jepet personit, i jepet ndërmarrjes së ShA ujësjellës kanalizime..Dhurata-ok, po çfarë funksioni do kryejë ta dimë, se deri tani nuk ka bërë asgjë për ujësjellësin, çka rëndësie ka person apo shoqëri, personi ka bërë aplikimin apo jo? Tani cili është funksioni, çfarë do bëj kjo shoqëri? Maksi- atë punë që kanë bërë deri dje. Dhurata-çfarë pune kanë bërë se asnjë gjë skanë bërë për Bashkinë tonë mesa shoh, andej nga Luari ska ujë fare, në Suk poshtë ai ujë është sterrë, se të vjen turp ta bësh publike kudo herë pas here, se u bëmë problematik kemi 3 vite, të paktën unë po. Maksi-ky është tjetër problem pastaj. Dhurata-po jo nuk është problem tjetër mos i anashkaloni tani, ajo shoqëri që do vij do bëj punën, në të kundërt mos të vij kot, të rrijë atje ku është dhe është në rregull, pse të shpenzoj kot. Maksi- atje po rri Dhurata, të lutem. Dhurata-po pastaj paguajmë dhe atë taksën 600 lekë ne, pse spunojnë e kam fjalën? Maksi-problemi qëndron se ata rrinë sot atje, rrinë pa qera..Dhurata-po çfarë pune po bëjnë të lutem, na kthe përgjigje. Maksi-punën që po bëjnë ata e diskutojmë në një mbledhje tjetër të Këshillit. Dhurata-po çka pune po bëjnë ata, skanë bërë asnjë gjë për ujësjellësin, nuk po bëjnë asnjë gjë dhe është për të ardhur keq. Kryetari-kam një pyetje, vlera e qerasë që do të vendoset, që u citua pak më sipër, do ketë nevojë që të ratifikohet edhe ajo këtu me një vendim të Këshillit apo pas këtij vendimi që ne marrim..Vjollca-jo, do vazhdojë me hartimin e kontratës së qerasë dhe përcaktimin e vlerës..Kryetari-dhe ajo kontratë kalon për miratim në Këshill? Vjollca-jo, kjo është thjeshtë në parim. Fredi-jo, prandaj duhet ta kishit sot vlerën. Selmani-pa u marr leja nuk vazhdohet dot. Fredi-mirë do ishte të ishte dhe vlera sepse ja keni dhënë një privati 500 m 6 milion lekë dhe ja lini atij gjithë ato zyra atje që është pasuri ja lini 300 mijë lekë e kupton, për shembull pa e paragjykuar

po në qoftë se. Selmani-ka referenca. Fredi-po prandaj thashë, pyeta ka referenca ska, ka klauzola ju prandaj se keni prurë. Leksi-një pyetje, në rast se ShA-ja kalon operator uji që ka thënë Kryeministri, do të duhet që ta anulojmë këtë qeranë në rast se do kalojë me shtet? Maks-i nderuar këshilltar sot ai po e merr me qera, qeraja ka një kontratë 1 vjeçare, 2 vjeçare me të drejtë përsëritje. Në qoftë se ai nuk paguan, në fund të kontratës shkruhet nëse ndonjë nga palët nuk bie dakort..Leksi-nëse ndryshohet nga ujësjellësi ShA bëhet operator shtetëror? Maks-i-pastaj ajo në qoftë se ndryshon statusin normalisht që do vij prapë në Këshill. Kryetari-dikush tjetër e kërkon fjalën për pyetje? Për diskutim në lidhje me këtë projekt-vendim? Atëherë asnjë nga këshilltarët nuk kërkon fjalën, ju ftoj atëherë që të votojmë projekt-vendimin “Për dhënien me qira të ambienteve përkatëse për tu përdorur si zyra administrative nga Shoqëria Rajonal Ujësjellës Kanalizime Fier ShA”.Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimit me 16 vota pro.

7.Për kalimin e pasurisë shtetërore në pronësi nga Bashkia Roskovec te Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në funksion të Postës së Policisë Roskovec.

Vjollca-të nderuar këshilltar ky projekt-vendim vjen si rezultat i gjithë bashkëpunimit..Dhurata-më fal, neve jemi dakort se e kemi parë materialin dhe herën e kaluar, mundet ta kalojmë për diskutim që mos të zgjatet vajza? Kryetari-pra nuk keni nevojë për relacionin përmbledhës? Dhurata-ska nevojë. Kryetari-atëherë faleminderit, për relatimin e gjejë të kaluar me të drejtë sepse e kemi diskutuar dhe në mbledhjen e kaluar të këtij Këshilli. Për pyetje atëherë e kërkon ndonjë nga këshilltarët fjalën? Për diskutim në lidhje me këtë projekt-vendim? Nuk ka. Kryetari-atëherë meqënëse pyetje dhe diskutime në lidhje me këtë projekt-vendim nuk kemi, ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimi “Për kalimin e pasurisë shtetërore në pronësi nga Bashkia Roskovec te Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në funksion të Postës së Policisë Roskovec”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimit me 16 vota pro (3/5+3 vota pro). Kryetari-me gjithë votat pro miratohet ky projekt-vendim, duke shpresuar që të kemi një shërbim më të kualifikuar dhe më afër qytetarëve nga ana e Policisë së Shtetit.

8.Për miratimin e dokumentit të rishikuar të PBA 2026-2028.

Kryetari-ftoj Drejtorin e Financës të Bashkisë Roskovec për të relatuar këtë projekt-vendim. Selmani-në vazhdim të projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028, ju paraqesim këtë projekt-vendim të këtij buxheti të rishikuar, me tabelat e paraqitura analitikisht dhe të cilët ju informojë që nuk kanë ndryshime me ato tabela që ne kemi paraqitur në muajin Qershor. Mbas miratimit të këtij vendimi, në muajt që vijnë me dëgjuesat përkatëse deri në miratimin e buxhetit vjetor dhe atij afatmesëm përfundimtar 2026-2028. Kryetari-atëherë për pyetje e kërkon fjalën njeri? Besoj tani u bë traditë që ne kalojmë PBA-të dhe e kemi besoj përvojën për ta vlerësuar këtë material. Për diskutim? Pyetje dhe diskutime nuk kemi, ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratimin e dokumentit të rishikuar të PBA 2026-2028”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet me 13 vota pro, 3 vota abstenim Dh.Malka, F.Feleqi, E.Xhaxhaj. Kryetari-ky projekt-vendim miratohet.

9.Për miratim fondesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2025.

Selmani-për miratimin e fondit prej 70,590 lekë, ky fond kishte të bënte me pagesën për 3 muaj për qera për biznesin, për gratë artizane dhe meqë kishte të bënte për dhënien me qera, marrjen me qera, normalisht duhet të kalojë në Këshill për miratim. Kjo është në bazë të materjaleve të sjella dhe nga drejtoritë përkatëse, mendojmë që për ecjen e këtij biznesi duhet ky vendim, një shumë e vogël ndoshta por do miratimin tuaj. Fredi-dhënien me qera, është privat ndërtesa apo e Bashkisë? Maksi-pagesën e vlerës. Selmani-pagesën e qerasë. Fredi-ambientet ku janë ata vendosur? Maksi-është privat. Fredi-sa kohë ka që janë formuar si shoqëri? Selmani-këta po bëjnë 2-3 vjet por kërkojnë këtë..Fredi-ça prodhojnë, artizan po ça prodhojnë? Selmani-prodhojnë nga më të ndryshmet. Fredi-të dimë ça prodhojnë, e kupton? Dhurata-kujt i shërbejnë? Selmani-është biznes. Fredi-nëse është biznes o ecën o nuk ecën, në qoftë se nuk ecën ai me 5 vjet, ai të mbahet me ashtu, më mirë shtoj administratën, ata punonjësit aty, i bie të shtojmë dhe administratën, paguajmë edhe atë kot se ashtu po vete. Selmani-po vete më keq. Fredi-po absolutisht po, unë nuk jam dakort me atë sepse prodhon diçka, të eci në treg ose ta kishim provuar dhe ne që ecën diçka, se qeranë po e bien po e paguajmë, gjëra pa lidhje. Selmani-3 muaj po kërkojnë. Fredi-kështu po vete ajo, me 3 muaj me 1 vit, të gjithë kanë nevojë të bëjnë biznes, në qoftë se ata janë të falimentuar, ne po i mbajmë me rixha, unë jam kundër sepse është lekë, aq lekë janë pak por për atë fshatin Ngjeqar atje aq lekë duhet të jenë shumë sepse është pa ujë. Dhurata-ashtu është. Maksi-të paktën Dhurata nga ty nuk e prisja, jam dakort me Fredin në moral dhe në llogjikë, por të paktën kemi të bëjmë me një grup grash që janë bashkuar. Dhurata-sa është numri i grave, cilat janë produktet dhe kujt i shërbejnë? Maksi-produktet ato i kanë personale dhe i shesin në emër të shoqatës, kur kemi pasur aktivitete i kanë ekspozuar në mënyrë vullnetare dhe pagesa është aq simbolike sa për të mos i futur ato në shtëpi, shuma është aq simbolike kështu që nuk e prisja, se janë 30 gra që bashkohen aty. Dhurata-30 gra janë ? sepse këtu vetëm njëra është, me respekt Farushe Hoxha, ajo i ka bërë kërkesën znj.Kryetare, emrat e grave të tjera nuk janë. Më fal sipas rregullit duhet të jenë emrat e të gjitha grave? Maksi-nuk është e thënë, është në emër të shoqatës. Dhurata-se unë di që kur bëhet një kërkesë, kur flasim në emër të të gjithë banorëve, shkruhen gjithë emrat dhe ata firmosin. Maksi-Kryetare e Shoqatës firmos. Kryetari-dikush tjetër e kërkon fjalën për pyetje në lidhje me këtë projekt-vendim? Për diskutim? Nuk ka. Kryetari-ju ftoj atëherë të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratim fondesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2025”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet me 13 vota pro, 3 vota kundër Dh.Malka, F.Feleqi, E.Xhaxhaj. Miratohet ky projekt-vendim.

10.Për miratimin e rregullores për menaxhimin e hapësirës publike në Bashkinë Roskovec.

Kryetari-ftoj specialisten për një relacion. Ndërkohë do doja tju bëja me dije sepse kam qënë pjestar i dëgjesës publike të mbajtur në lidhje me këtë rast, kam shprehur atje dhe vërejtjet e mia në lidhje me këtë projekt-vendim. Besoj që kemi interes për të dëgjuar një relacion të shkurtër. Do ju lutem një relacion të përmbledhur të asaj që na keni paraqitur bashkë me projekt-vendimin. Dr.Urbanistikës Eneida-të nderuar këshilltar, në vijim të nevojave dhe problematikave të hasura në rregullimin e kuadrit ligjor mbi hapsirat publike, ju paraqesim rregulloren për shfrytëzimin e hapsirave publike të Bashkisë Roskovec. Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave dhe të procedurave për përdorim, shfrytëzim dhe menaxhim të hapësirës publike në përputhje me

legjislacionin në fuqi. Ajo që doja tju thoja është aktivitetet e lejuara për përdorimin e hapsirave publike. Aktivitetet janë : ofrimi i shërbimeve rekreative dhe kulinare, zhvillimi i aktiviteteve ambulatorie në hapsirën publike, ekspozimi i mallrave jashtë njësish të tregimit, zhvillimi i panairove, zhvillimi i aktiviteteve argëtuese, kulturore, manifestimeve, ofrimi i shërbimeve në bar-kafe, ushqime të shpejta, pije freskuese, hapsirat reklamuese, struktura provizore shërbimi. Proçedura e aplikimit është në bazë të një sërë dokumentash, i interesuari për zënien e hapsirës publike paraqitet në Bashki dhe Drejtoria e Planifikimit rast pas rasti shqyrton kërkesat, bën një plan, përcaktohet vlera bashkë me Drejtorinë e Taksave dhe miratohet ose rregullohet në bazë të rastit. Ajo që vlen për tu përmendur është që koha maksimale e lejimit të hapsirës publike, e lejes së shfrytëzimit është 2 vjet dhe për çdo rast nuk mund të lejohet më shumë se 200 m². Maksi-ne kemi një rregullore të Bllokut Nr.2 të miratuar në Këshillin e Bashkisë dhe mbetet e domosdoshme sot që Roskoveci të ketë një rregullore për funksionimin e hapsirës publike. Ajo e Bllokut 2 është e miratuar në Këshill, janë shtuar ato elemente sipas legjislacionit në fuqi. Kryetari-për pyetje në lidhje me këtë projekt-vendim? Po fjala është për z.Fredi dhe pas tij z.Leksi. Fredi-kemi pasur ne lëshim hapsirash si rast, lokale, dyqane kemi pasur? Dyqanet që kanë sot çuar perimet në trotuar i kanë jashtë ligjit, kemi pasur neve marrveshje me ata? Eneida-jo. Fredi-lokalet, karriget siç janë prishur ato, këtu tek ne kemi pasur dhënie me qera? Eneida-kjo rregullore është për të rregulluar këto marrdhënie. Fredi-e kuptoj çka është, e kam lexuar, deri këtu kemi pasur ne aplikime? Eneida-kemi pasur aplikime për dhënie me qera po, për shfrytëzim. Fredi-doja të dija sepse nuk isha në dëgjuesë publike, si ishin mendimet e grupeve të interesit, ka kundërshtime ose jo sepse normalisht këta janë të interesuar apo jo, si e pritën? Eneida-përveç se disa sqarimeve për distancat, sipërfaqet, nuk kishte kundërshtime. Emels-ishin dakort që të gjithë që të paguanin? Eneida- për zënien e hapsirës shtet po. Emels-për zënien e hapsirës shtet po bëhet fjalë, po për pjesën e pagesës si do funksionojë? Është komisioni ai që vendos? Nuk ka një tarifë fikse paraprake që ne duhet ta dimë, që të aplikojmë për 10 m² edhe tarifa është fikse? Eneida-çdo biznes ka të drejtë të aplikojë për hapsirë publike përgjatë frontazhit të vet që ka hapsirë, por asnjëherë më shumë se 200 m², në asnjë rast. Për çdo rast merret parasysh, është e parashikuar në Paketën Fiskale. Fredi- ka tarifa fikse? Eneida-po. Emels-atë do të thoja, tarifa është fikse apo gjithmonë varet nga pozicioni se ku ndodhet? Eneida-jo, është fikse dhe është e parashikuar në Paketën Fiskale. Maksi-për këtë në qoftë se doni kemi dhe drejtoreshën e taksave aty, të japi një përgjigje më të saktë. Dr.Taksave Orgesa-çmimi është 120 lekë m² në qytetin e Roskovecit dhe 80 lekë m² për fshatrat. Emels-bëhet fjalë tarifë vjetore gjithmonë apo mujore? Orgesa-mujore, është 120 lekë m² në muaj. Fredi-në muaj? Orgesa-po, dhe 80 fshatrat. Leksi-ka dal Vendimi i Këshillit të Ministrave, rregullorja del mbi Vendimin e Këshillit të Ministrave apo rregullorja është derivat i Vendimit të Këshillit të Ministrave? Eneida-është derivat i Vendimit të Këshillit të Ministrave. Leksi-dua të dal këtu, Vendimi i Këshillit të Ministrave i ka përcaktuar, kjo rregullore tani pse duhet të jetë shtesë, apo..? Maksi-as modelin e tendave nuk i ka përcaktuar Vendimi i Këshillit të Ministrave, as hapsirat sesa do të jenë e të tjera me radhë..Leksi-unë di që ka përcaktuar 25% do zëri ai, 75%, pse duhet të ketë kërkesë të vazhdueshme përshembull për zënien e këtyre hapsirave, më kupton? Maksi-këtu ka të bëjë dhe me tarifën. Leksi-po në rregull dakort, ai ka thënë 25%..Maksi-po dakort, po se merr 25%. Leksi-75% për këmbësorët dhe 25% për atë, kjo është e përcaktuar pse duhet të ketë rregullore? Maksi-mbase se do të gjithën ai fermeri apo ai biznesmeni i lokalit. Leksi-mua më ngjanë pak e paqartë, jo për mua se unë skam ndonjë interes kështu po për ata domethënë të gjithë çka janë grupet e interesit, dhe ata atë ditë nuk është se nxorën ndonjë gjë në dritë nga diskutimet. Dhurata- pyetjen

e Leksit kisha gati-gati, unë kisha hallin këtu tani që ju e keni hartuar rregulloren dhe ne do ta miratojmë sigurisht si grup opozitar, por keni marr urdhër nga lartë të paktën se mos vjen i prish si andej nga Thethi? Maksi-spo japim leje për ndërtim.. Dhurata-këtë hall kisha unë. Maksi-po japim rregullore për të sanksionuar rregullat. Dhurata-shpresojmë. Fredi-për diskutim kisha dhe një gjë tjetër, propozim. Do desha që pas miratimit përfundimtar nga drejtoria që do ta miratoj, ne si Këshill duam një fotokopjo të gjithë aplikantëve dhe miratimin e sipërfaqeve në qoftë se është e mundur, ne mund ta marrim dhe kështu por mund ta bini këtu sepse mos të vemi atje, ne e duam si Këshill. Maksi-për lejet që do të jepen nga momenti i miratimit..Fred- lejet do të jepen sepse ne do ta miratojmë që të jepen absolutisht, problemi është aplikantët, ka aplikuar Fredi Feleqi 16m, tarifa, e kupton? Kryetari-po, transparencën. Fredi-po për hir të transparencës. Maksi-është e drejta juaj dhe detyrimi ynë. Fredi-jo absolutisht e di që është e drejta jonë por për mos të ardhur ne në sportel, te zyra e informacioneve. Emels-sepse normalisht duhet të kesh dhe një bazë kriteresh, ku do japim ne leje e kupton? Kryetari-po rregullorja këtë presupozon. Maksi-kjo do jetë në bazë të kërkesave. Emels-ok, un mund të bëj kërkesë, mund të kem ambicje të mëdhaja, mund të zë gjithë trotuarin por smundem ta zë sepse do kalojnë dhe qytetarët, se ka vende që mua mbase më lind oreksi për tu hedhur dhe nga Kinemaja e kupton, por smë lejohet. Në vende të caktuara mund të kem dëshirë unë për ta përfutur atë si hapsirë publike por kush janë kriteret që ne do vendosim që e përfiton ose se përfiton, se nuk mund të jetë një njeri i vetëm që mund të marri këtë lloj vendimi që ti e përfiton dhe unë se përfitoj, se këtu i bie burokraci pastaj. Eneida-tek rregullorja është e përcaktuar që minimum i kalimit të trotuarit është 1.5m. Në asnjë lloj rasti në qoftë se kjo çenohet, pra është më pak se 1.5m nuk jepet leja e shfrytëzimit, pra 1.5m do të rrijë trotuar në çdo sipërfaqe, mbi 1.5m do filloj të aplikohet. Kryetari-kisha një pyetje, jeni bazuar në formulimin e kësaj rregullore në ndonjë përvojë nga bashki të tjera, apo? Eneida-po, përveç Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec, janë marr bazë rregulloret e bashkive më të mëdha që janë përshtatur më të dhënat e Bashkisë Roskovec. Emels-duke pasur parasysh që të gjithë këto bizneset që preken nga kjo gjëja këtu, normalisht një pjesë e mirë e tyre janë në kushtet e mbijetesës dhe duke i shtuar dhe këtë lloj barre ne, mua më duket pak..si tek pjesa e çmimit më kupton sepse ajo është një vlerë e konsiderueshme mendoj unë, duke qënë se është dhe mujore dhe është një barrë e shtuar për të gjithë bizneset, për të gjithë këta që ushtrojnë biznes këtu në qytetin tonë, prandaj unë jam kundër kësaj gjëje, mendoj të rishikohej edhe puna e çmimit sepse 1200 lekë janë shumë. Fredi-metri katror në muaj dhe 1800 Roskoveci? Eneida-jo, 1200 Roskoveci dhe 800 fshati. Fredi-12 mijë lekë m². Maksi-jo 12 jo, 1200 lekë të vjetra m², po more 70 m i thonë përafërsisht 100 mijë lekë. Fredi-mirë pra këtë kanë kundërshtuar ata që e thashë unë, ata kanë kundërshtuar çmimin, ne kemi si Këshill ti ulim tarifat? Maksi-flas në emër të Ekzekutivit, në dëgjuesën publike nuk e kundërshtuan përkundrazi paraqitën dakortësinë për të qënë bashkëpunues. Kryetari- ne mesa kuptova dhe nga dëgjesa publike, kemi përgjegjësinë e vlerësimit të situatës sepse ky trotuar që ne po diskutojmë dhe diskutojmë dhe vlerën tani, u dha përgjigje për vlerën në fillim, po në miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2026 që do ta bëjmë në këtë Këshill, që e bëjmë zakonisht në Dhjetor, aty mund të ridiskutohet pikërisht tarifa. Për vitin 2025 ne e kemi vendosur tarifën por nuk ka ndonjë domethënie sepse..Fred-po se si kemi pasur fare këto aplikime ne, mund ta ndryshojmë dhe tani. Kryetari-jo ne nuk mund ta ndryshojmë, aa mund të ndryshojmë Paketën Fiskale? Fredi-atë pjesë. Kryetari-patjetër, patjetër procedura është e hapur. Gjithsesi unë do ju thoja që përgjegjësia jonë është që të shikojmë dhe anën e qytetarit, aty ku është vështirësuar le të themi ne kalimi. Për punën e tarifës ne mund ta diskutojmë, sigurisht që ne mund ta

diskutojmë pjesën e tarifës por do arrinim tek ai niveli që tha këshilltari para folës që në qoftë se tarifa do të ishte kaq e ulët, atëherë oreksi për të zënë sa më shumë hapsirë..Fredri-po nuk ka mundësi ai sepse ajo thotë dhe llogjika është përpara lokalit, nuk ka pse të vij ai atje dhe të marri këtu, e kupton e përcakton ligji. Kryetari-po patjetër. Leksi-të bëj një pyetje shitesë, tani këto tarifa vendosen për mos ti nxjerrë ata në hapsirën publike apo për të punuar? Sepse kur vendoset kaq e lartë përshembull e di që një pjesë do stepen. Kryetari-jo mo nuk është e lartë, ti e gjykon të lartë. Maksin-dëgjuesin publike të gjithë tregtarët po e them edhe njëherë ranë plotësisht dakort për bashkëpunimin në këtë mes. Leksi-po pra, por tha dhe Kryetaria këtë, në momentin që do aplikoni tha do tërhiqeni prapë tha, se bën më shtrenjtë jashtë se brenda apo jo kështu tha, do të thotë llogjika që ata mos ti nxjerrin. Maksin-të lutem, ke 30m brenda në lokal dhe mund të kërkojsh 200 jashtë. Leksi-jo se nga 30 që ka lokalit nuk e çon 200 jashtë ai jo. Emels-ne nuk shikojmë në një lokal 30 veta bashkë e para e punës. Maksin-30m brenda lokalit po them unë. Leksi-shikojeni këtë tarifë në fund të Paketës Fiskale, të shikohet kjo tarifë, sa na e jep ligji 30% ta ulim. Maksin-të ndryshojmë tarifën duhet të bëjmë një dëgjues publike me qytetarët. Leksi-po në rregull dakort, bëj ato që të takon. Emels-tani problemi është se ti i referohesh dëgjuesin publike dhe thua grupet e interesit, unë e pashë pak atë dhe se kush ishin pjesëmarrës në atë dëgjues publike, pjesa dërrmuese ishin pa lidhje fare, skishte lidhje as me biznesin, as me asnjë lloj gjëje dhe po të pyesësh ata ti nga 1200 që thamë ne këtu dhe 12 ta vësh për ata mirë është nuk është keq, vetëm bjeru thotë ai hiqja këtij. Ska sens ky muhabet, tani merret si referencë ato dëgjesat publike, ok po në dëgjesat publike duhet të ishin njerëz që me të vërtetë preken nga kjo lloj gjëje. Në rast se ata japin dakortësinë, dakort ishim edhe ne. Mua më duket pak abuzive për veten time, nuk e di. Maksin-unë them që në Tetor jemi, 3 muaj janë dhe pastaj të kemi mundësi për të diskutuar tarifën, se do hapet aplikimi Nëntor, Dhjetor, pastaj kemi kohë që në Paketën Fiskale që kemi për të miratuar, sa të marri miratimin e Prefekturës e të tjera me radhë, është koha e domosdoshme që në Paketën Fiskale që do diskutohet të kemi dhe këto tarifa. Kryetari-pra jemi në kohë për të diskutuar tarifën. Leksi-të ulët sa na e jep ligji 30%. Fredri-në qoftë se do kemi aplikime tani do rishikojmë tarifën. Maksin-pra do ta bëjmë përpara Dhjetorit. Dhurata-aktualisht ka aplikime? Eneida-ka, të paktën 3-4 aplikime. Kryetari-atëherë faleminderit, dikush tjetër e kërkon fjalën për pyetje apo diskutim në lidhje me këtë projekt-vendim? Nuk ka. Kryetari-ju ftoj atëherë të nderuar këshilltar të votoni projekt-vendimin “Për miratimin e rregullores për menaxhimin e hapësirës publike në Bashkinë Roskovec”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet me 13 vota pro, 3 vota kundër Dh.Malka, F.Feqi, E.Xhaxhaj. Miratohet ky projekt-vendim.

11.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Kryetari-dikush nga këshilltarët e kërkon fjalën për diskutim apo koment? Po ju pyes përpara se të kalojë në përgjigjet e ardhura nga ana e administratës në lidhje me pyetjet e ngritura në këtë Këshill në mbledhjet e kaluara. Emels-një pyetje për Maksin, e kam bërë si pyetje dhe në një mbledhje tjetër, për pjesën e asaj tabelës tek rruga që ikën poshtë tek lokalit i Benit të Veliut, ndodhet një tabelë që ka ngelur që kur ka qënë pedonalja e bllokuar dhe ka ngelur akoma, e kupton? Gjithë qytetarët përditë nga policia e shtetit dhe më the që do e shikoj me specialistët dhe asnjë lloj zgjidhje nuk keni marr dhe ajo tabelë nuk është hequr. Maksin-ajo tabela nuk hiqet po qe se nuk merret një vendim që të jemi korrekt, dhe ajo tabela atje për parkim mesa është konsultuar me specialistët dhe me Drejtorinë e Policisë së Fierit, nuk ka vend për parkim, na është

kthyer përgjigja prerë që nuk ka vend atje që të parkohen makinat nga të dyja anët, është nga njëra anë jo nga të dyja anët. Emels-po sepse ajo ka qënë funksionale dhe kanë qënë makinat, parkoheshin para se të bllokohej pedonalja kryesore e qytetit, në momentin që u bllokua pedonalja u bë parkimi vetëm në një krahë. Në momentin tani që është hapur pedonalja llogjikisht i bie që të hapet parkimi në të dyja krahët e rrugës. Maksi-po parkim në të dyja krahët jo se ska rrugë, nuk ka hapsirë, është diskutuar dhe me policinë e qarkullimit..Emels-po hapsirë ka aty se ne aty kemi qënë. Fredi-aty parkoheshin nga të dyja krahët. Maksi-prapë bllokohet qarkullimi në atë pjesë. Fredi-ti kontrolloje, ti bësh një kërkesë se nuk është ndonjë rrugë kushedi se çfarë. Maksi-e kemi bërë kërkesën, kam dhe Benin po se kam sot këtu. Fredi-epo mbase e keni bërë para se..Maksi-jo jo tani e kam bërë kërkesën. Pegiola-meqë jemi shumica e grupit këtu e të gjithë këshilltarëve, kisha një kërkesë në lidhje me orarin. Nëse është e mundur me shumicë votash nëse biem dakort që orari të shtyhet me dy orë, orari i fillimit të mbledhjes të shtyhet me dy orë, të paktën me dy orë. Kryetari-pra ju propozoni që mos të përdorim orarin që kemi përdorur tradicionalisht. Nuk e di, kjo do kërkonte mirëkuptimin besoj unë të pjesës më të madhe. Fredi-mirë është por problemi është se po vjen dimri, do zgjasi 4 orë..Në sallë ka diskutime midis këshilltarëve në lidhje me këtë çështje. Elisabeta Toska-personalisht edhe unë jam dakort me këtë orar. Maksi-dhe për ju në orën 3? Elisabeta-po. Kryetari-ok, atëherë meqënëse jemi pjesa më e madhe e këshilltarëve të pranishëm në këtë mbledhje të Këshillit, dëshironi ta bëjmë..Dhurata-kur një person vjen 1 herë në 4 mbledhje dhe ta shtyjme, jo. Kryetari-nuk po detyrojmë asnjë vendimmarrje por po mundohem ta bëj pak më transparente. Kush është dakort në parim për ndryshimin..Ka diskutime midis Dhuratës dhe Pegiolës. Kryetari-për konsensus po ju pyes kush është dakort? Dhurata-për ndryshim? Kryetari-po, për ndryshim orari. Leksi-po të na pyesësh një për një ne do japim orare të ndryshme, vendoseni në Kryesi ju të Këshillit atje ça keni dhe si të bëhet më mirë. Dhurata-unë nuk mendoj për ndryshim sepse nuk vjen në çdo mbledhje. Kryetari-ore më lër të kuptoj se shumica çfarë do. Leksi-merrni mendimet e secilit dhe e vendosni në Kryesi. Kryetari-jo nuk marrim mendimin e secilit por marrim mendim në grup dhe po ju pyes për konsensus, pjesa më e madhe është për ta ndryshuar apo jo? Leksi-unë jam për në orën 10. Dhurata-ne jemi gjithmonë këtu por ama gjithmonë në mbledhje ske ardhur, 1 herë në 5-6 mbledhje vjen. Në sallë ka zhurmë dhe diskutime midis këshilltarëve të cilët po flasin njëkohësisht. Elmazi-unë jam dakort me orarin e Këshillit që ne e kemi vendosur në orën 1 bashkë për të gjithë, kërkesat mund të jenë nga më të ndryshmet, por më e mira është ora 1 në gjykimin tim. Emels-në gjykimin tim është në orën 5 mbase. Fredi-ne vazhdojmë me këtë orar që kemi, pastaj po e pamë të arsyeshme ta ndryshojmë. Unë kisha një kërkesë, ne si fshat nuk kemi ujë as për pirje as vaditje, shqyrr zotit kemi një rezervuar dhe të ishte Kryetarja e Bashkisë këtu, dhe atij rezervuari i është bërë ushqyes, shqyrr zotit u bë dhe ai ushqyes, mirëpo është shumë krizë dhe njerzit po e mbajnë ujin me depozita. Ju u duket shumë po është sinjerisht dhe ata pusët me sondë janë tharë. Të shikohet një mundësi nga Bashkia, një transformator të zbritet atje tek rezervuari dhe një tubacion përmes fshatit kryesor, me kështu me faturim. Është bastardim e kupton? Tani të vij infermierja e fshatit ska ujë për të larë gjilpërën, ose lokalet, ose i gjithë fshati e kupton? Me zëtor, me makina po mbahet uji, të gjendet një emergjente, mua nuk ma merr mendja se është shumë lekë, një transformator 3-4 milion lekë, një tubacion plastik.. Kryetari-për ta përdorur si ujë komunal. Fredi-absolutisht, ore ai që ka ta përdori, të gjendet një tarifë e mesme jo për të pijshëm dhe është zgjidhje, se nuk ka zgjidhje të ujit të pijshëm, hajt se do zgjidhet këtë 4-vjeçar, kjo që po them unë është emergjente, kur aty ka arritur po mundohem unë të marr ujin ta bie në shtëpi privatisht. Atje do ta marrin shumë njerëz po ne si

Bashki që edhe ta administrojmë, edhe të marrim diçka por edhe të gjejmë zgjidhje për qytetarët. Mua më duket sepse nuk jam i asaj fushe, po më duket një tubacion përmes fshatit sepse tubacioni kryesor nga rezervuari deri në një pikë është tubacion hekuri por ne të çojmë një plastik, nuk ma merr mendja se 3km tubacion do kushtojë dhe një transformator rregullator. Kjo që po them unë është në ndihmë të qytetarëve, është emergjente, në qoftë se po blejmë pompë 18 milion lekë për vaditjen ne kemi qënë të gjithë pro, në mbledhjen tjetër të sillet një plan dhe ta miratojmë. Nuk është as për një gjë ta them singerisht. Maksi-kaq e thjeshtë fare nuk është se kërkon projekt..Fredi-unë sjam specialist po them..Maksi-transformatori do dhe elektropompën pastaj nga pas..Fredi-absolutisht. Maksi-do dhe punonjësin. Fredi-unë spo të them që është e lehtë, unë po ta bëj llogari se unë e kam bërë privatisht se sa bën transformatori, sa bën tubacioni dhe sa bëjnë të gjitha..Maksi-do dhe elektropompë thashë. Fredi-po mirë dhe elektropompën, po them edhe elektropompën, po atëherë për çfarë jemi ne si Bashki këtu? Maksi-po mirë dakort, ajo do parë, do ngritur komisioni për ta parë..Fredi-mirë absolutisht, ajo është emergjente o Maksi, ja aty është dhe Nazmiu, është shumë emergjente. Maksi-por kërkon një projekt ta thashë edhe njëherë. Fredi-po ta bëjmë ne emergjente do ta bëjmë edhe atë projektin. Në qoftë se duhet ndihmë edhe ne si fshat, është emergjente dhe na vjen zor tu dalim njerzve përpara. Nazmiu-janë miratuar dy çezma në Ngjeqar dhe njëra është bërë si ajo legjenda e Rozafës, u bënë 4 vjet dhe sot e kësaj dite nuk është zgjidhur problemi. Ajo e dyta po..biles ka premtuar Kryetarja për ta bërë plus dhe një çezëm tjetër, deri më sot nuk është bërë asgjë, të paktën për tu ardhur në ndihmë komunitetit, vera ishte shumë e thatë dhe e nxehtë, të paktën të venë të mbushin ujë atje me mjete primitive, po nuk ka sepse atje është hedhur betoni me atë të vjetrën, ajo nuk mban asnjë pikë ujë. Dhe tjetra mbase nuk është kompetencë e Këshillit, është një gabinë që është në tokë aty në qendër, aty ka problem me fëmijët, luajnë në tokë, gjeneratori është në tokë fare, as 5cm mbi tokë. Maksi-për këtë do flas që nesër me OSHE-në. Nazmiu-në rrjetin elektrik, në disa parcela fermerët nuk arrijnë dot të punojnë tokat sepse nuk vete mjete se prekin telat e energjisë elektrike në gabinën e zëtorit. Është shumë e vështirë, këto janë probleme që duhen zgjidhur, mbase nuk është në kompetencën tonë por..Maksi-unë të thashë që nesër do flas. Nazmiu-në Ngjeqar janë bërë mbi 200 e ca çpime, po bëjnë nga 10-15 vjet që janë bërë çpimet, sot e kësaj dite nuk e kemi ujin të kontrolluar. Të ndërhyet tek ujësjellësi në qoftë se ata bëjnë dizifektimin e këtyre depove kundrejt një tarife pse mos të bëhet dhe në familjet tona, dhe ne të kemi një diçka të kontrolluar. Në lidhje pastaj me atë që tha Fredi kjo është e vërtetë, ndihmon shumë se ka familje që edhe bagëtisë nuk i jep dot ujë sepse nuk ka, ndërsa po të kalojë dhe ai uji te rezervuari, ai nuk përdoret për të pirë, as edhe për të larë nuk përdoret po të paktën ca probleme për larje, për bagëti..Fredi-ore dhe për derdhje, ka shumë zgjidhje se për të pirë nga 10kg ujë po pijmë. Nazmiu-shkolla sot po bën 1 muaj që është hapur, në Ngjeqar nuk ka ujë. Fredi-në lidhje me atë se e harrova, ajo mund të përdoret edhe për shkollën sepse për larjen e banjove duhet uji i shkollës. Maksi-tani për shkollën e keni parasysh që e keni ngritur disa herë, jo pompa..Fredi-jo pompa mbaroi, nuk është për pirje ai, për pirje as ai që ishte nuk bënte. Kryetari-po përfitoj nga rasti të bëj dhe unë një kërkesë që ma transmetuan bashkëqytetarët e mi në Njësinë Kuman. Në qoftë se keni informacion z.Maksi, kur do përfundojë rruga dytësore nga fusha e sportit për në lagjen Shurdhenj? Sipas tabelës më referuan se kemi edhe shumë pak ditë deri në përfundim të afatit, ndërkohë që punimet tregojnë që nuk mund të mbyllet në atë afat. Maksi-ne kemi pasur një takim para disa ditësh, investitorët, supervisorët, kolaudatorët e të gjitha veprave në të gjitha punimet dhe kemi kërkuar zbatimin e të gjitha orareve të domosdoshme. Ne duke filluar që nga fusha e sportit që ka një grafik punimesh, ka dhe një miratim

grafiku, për të gjitha supervizorët kanë thënë që ne do të jemi brenda grafikut. Ne kemi thënë në fund që moszbatimi i grafikut do të penalizojë sipas ligjeve në fuqi dhe nuk do të ketë asnjë lloj investitori që ka bërë punime në Bashkinë Roskovec pa u penalizuar në qoftë se kalon afatin. Leksi-unë këtë kërkesë e kam bërë dhe në mbledhjen e parë, kemi parë tabela por nuk shikojmë investime, dhe në tabela është shkruajtur vetëm lidhja e kontratës, është shkruar vetëm afati i mbarimit të punimeve 2 muaj ose 4 muaj. Kryetari-për rastin e referuar nga ju, e kemi pjesë të përgjigjeve. A doni ti dëgjoni përgjigjet e kërkesave që keni bërë? Leksi-po bieri, na i lexo. Kryetari-kush dëshiron ti dëgjojë, që ka bërë kërkesë dhe dëshiron që ta dëgjojë përgjigjen, le të presi dhe 2 minuta. Kryetari fillon të lexojë kthimin e përgjigjeve të ardhura nga administrata. Këshilltarët nuk kanë interes dhe ngrihen të firmosin procesverbalin dhe të largohen. Mbyllet mbledhja.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Afrim Plaka

